



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 106 Datë 20.07.2012

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË HEC “ULËZ - SHKOPET” SH.A NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, gërma “ a ” ; 9, dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ f ”, 5 pika 1 gërma “ f ” dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës __.07.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”) janë paraqitur dhe plotësuar ne menyre korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë informacion të detajuar.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike për një afat 5 - vjeçar.
2. Licensa e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike do të fillojë efektet e saj ligjore mbas procesit të privatizimit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI